



Kërkesë për propozim dhe TeR për vlerësimin e jashtëm

KËRKESË PËR PROPOZIM

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, lokacioni Fushë Kosovë

EMRI I PROJEKTIT	PROGRAMI I FUQIZIMIT TW FAMILJËS, LOKACIONI FUSHË KOSOVË
LLOJI I SHËRBIMIT	KOMPANI PËR TË OFRUAR VLERËSIM TË JASHTËM
VENDNDODHJA	FUSHË – KOSOVË
I RAPORTON	SOS FSHATRAVE TË FEMIJËVE KOSOVË
AFATI KOHOR I PRITUR	MAJ-KORRIK

Kërkesë për propozim dhe TeR për Vlerësimin e Jashtëm

1 Konteksti dhe arsyetimi

1.1 Rreth SOS Fshatrave të Fëmijëve Kosovë

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë është pjesë e një federate globale prej 134 Shoqatave Kombëtare të SOS Fshatrave të Fëmijëve, që punojnë në më shumë se 2000 lokacione të programit në mbarë botën. Ne punojmë së bashku me një vizion të vetëm: çdo fëmijë i përket një familjeje dhe rritet me dashuri, respekt dhe siguri.

Që nga viti 2001, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë janë aktive në fushën e mbrojtjes sociale përmes ofrimit të shërbimeve cilësore të kujdesit të drejtpërdrejtë për fëmijët dhe të rinjtë pa kujdes prindëror dhe përmes ofrimit të shërbimeve për fuqizimin e familjes për familjet në rrezik të humbjes së kujdesit prindëror. Në SOS Fshatrat e Fëmijëve, Kosovë, ne punojmë së bashku drejt vizionit tonë për një botë ku “çdo fëmijë i përket një familjeje dhe rritet me dashuri, respekt dhe siguri”.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë punojnë në partneritet të ngushtë me institucionet qeveritare, organizatat e shoqërisë civile dhe ofruesit e shërbimeve për të ndikuar në ndryshimet në praktikë dhe në politika në fushën e mbrojtjes sociale.

1.2 Përshkrimi i vendndodhjes dhe kontekstit të programit

Programi për fuqizimin e familjes në Fushë Kosovë si tërësi është themeluar në vitin 2013, ofronë shërbime psikosocial për përfituesit e saj. Përmes. Nëpërmjet një game të gjerë të ndërhyrjeve, duke përfshirë aktivitete psikosociale, mbështetje arsimore, assistencë shëndetësore dhe iniciativa avokuse për mbrojtjen e rë drejtave, programi është i përkushtuar për fuqizimin e mirëqenies së familjeve në rrezik. Objektiva kryesore përfshinë fuqizimin e rrjeteve komunitare për mbrojtjen e fëmijëve në nevoj ndërsa promovon rezultatet holistike.

Duke synuar në mënyrë strategjike familjet më të marginalizuara, programi përpiqet të zbusë rrezikun e braktisjes së fëmijëve dhe shpërbërjes së familjes. Nëpërmjet qasjes së tij sistematike, programi jo vetëm që trajton sfidat e menjëhershme, por gjithashtu e siguron rezilencën e qëndrueshëm brenda strukturës së komunitetit. Kjo nismë profesionale shërben si një mekanizëm jetik për nxitjen e fuqizimit dhe sistemeve mbështetëse të qëndrueshme, duke kontribuar në këtë mënyrë në mirëqenien dhe stabilitetin e përgjithshëm të familjeve në rajonin e Fushë Kosovës. Aktualisht, programi i forcimit të familjes mbështet 115 fëmijë, 82 të rritur/të rinj. Në total 197 pjesëmarrës në 31 familje. Lokacioni i Fushë Kosovës përbëhet nga nacionaliteti shqiptar, rom, ashkali dhe egjiptian. Janë 14 familje shqiptare, 16 familje rome, ashkali dhe egjiptiane (RAE) dhe një familje boshnjake në Programin e Fuqizimit të Familjes..

Grupi i synuar i FSP Fushë Kosovë është:

- **Pjesëmarrës fëmijë dhe të rinj:** Ky target grup përfshin fëmijët dhe të rinjtë që janë në rrezik të madh për t'u privuar nga mjedisi familjar: fëmijët dhe të rinjtë që kanë status të ulët arsimor, ushqimor, shëndetësor dhe jetojnë në kushte shumë të vështira jetese; fëmijët dhe të rinjtë që vijnë nga familje me probleme sociale dhe të ardhura të ulëta; fëmijët dhe të rinjtë që i nënshtrohen dhunës brenda familjes; fëmijët dhe të rinjtë që kanë braktisur shkollën ose nuk janë regjistruar kurrë në shkollë.
- **Pjesëmarrës të rritur:** Ky target grup përfshin prindërit me shumë fëmijë; prindër që kanë nivel të ulët arsimor dhe janë të papunë; nënat vetëushqyese, familjet që kanë fëmijë me nevoja të veçanta; familjet e vëllezërve apo të afërmeve që kujdesen për fëmijët pa përkujdesje prindërore etj.
- **Partnerët:** OJQ-të, institucionet që punojnë në fushën e kujdesit ndaj fëmijëve, të drejtave.

Të bëhet një vlerësim i jashtëm me qëllim të vlerësimit të ndikimit të ndërhyrjes në ngritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve sociale në programin e fuqizimit të familjes në Fushë Kosovë. Konkretisht, vlerësimi do të fokusohet në efektivitetin e ndërhyrjes në parandalimin e

Kërkesë për propozim dhe TeR për Vlerësimin e Jashtëm

ndarjes së familjes dhe promovimin e mirëqenies së 31 familjeve, 115 fëmijëve dhe 25 të rinjve, të cilët janë në rrezik për të humbur kujdesin prindëror.

Parimet e programit të forcimit të familjes për fëmijët dhe familjet janë:

1. Vendi më i mirë që fëmijët të rriten është “brenda familjes së tyre biologjike
2. Prindërit/kujdestarët janë përgjegjës për zhvillimin e fëmijëve të tyre
3. Komunitetet janë një burim i drejtpërdrejtë i mbështetjes për fëmijët dhe familjet e tyre
4. Qëllimi i zhvillimit është realizimi i të drejtave të njeriut. Vajzat dhe djemtë, si edhe kujdestarët e tyre, kanë të drejtën e të gjitha të drejtave, siç shprehen në traktatet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Objektivat specifike

Niveli i fëmijës

- Sigurimi që fëmijët do të kenë qasje në sistemin arsimor për fëmijët;
- Sigurimi që fëmijët do të kenë strehim të qëndrueshëm dhe të përshtatshëm;
- Sigurimi që fëmijët të kenë ushqimin e nevojshëm dhe të marrin kujdesin shëndetësor në përputhje me nevojat e tyre;
- Sigurimi që zëri i fëmijëve të dëgjohet, duke u dhënë atyre mundësinë të marrin pjesë në mënyra që ata të jenë në gjendje të shprehin plotësisht veten e tyre;
- Ne i ndihmojmë fëmijët të zhvillojnë potencialin e tyre të plotë përmes përvojave pozitive, sociale, emocionale, fizike dhe intelektuale.

Niveli familjar

- Kujdestarët e cenueshëm do të përmirësojnë kapacitetin e tyre prindëror dhe do të jenë në gjendje të plotësojnë nevojat zhvillimore të fëmijëve të tyre;
- Familjet e cenueshme do të integrohen më mirë për nga aspekti social në komunitetet lokale;
- Familjet në nevojë do të përmirësojnë gjendjen e tyre ekonomike dhe do të jenë të vetëqëndrueshme ekonomikisht;
- Familjet në nevojë do të përmirësojnë aftësitë e tyre profesionale;
- Familjet përdorin shërbimet thelbësore mbështetëse për të përmbushur nevojat e zhvillimit të fëmijëve;
- Familjet kanë ose kanë qasje në burimet financiare dhe materiale të nevojshme për të siguruar përmbushjen e të drejtave dhe nevojave të fëmijëve të tyre.

Niveli i programit:

- Përmirësimi i cilësisë dhe qasjes në shërbime psiko-sociale dhe në shërbimet për fëmijët dhe familjet në nevojë;
- Përmirësimi i shërbimeve për mbështetjen e fëmijëve dhe prindërve përmes ofrimit të shërbimeve cilësore mbështetëse arsimore dhe shërbimeve psiko-sociale;
- Zvogëlimi i cenueshmërisë ekonomike të grupeve të cenueshme (të rinj, gra, kujdestarë nga familje të pafavorizuara shoqërore dhe ekonomike) nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të ndryshme mbështetëse të punësimit;
- Rritja e ndërgjegjësimit të autoriteteve qeveritare dhe joqeveritare për sa i përket ndërhyrjeve të larmishme dhe efektive për familjet në nevojë;

Në kuadër të FSP, synimi kryesor është fuqizimi i familjes, i cili arrihet duke punuar në dy qasje kryesore: fuqizimi i familjes dhe fuqizimi i komunitetit për fuqizimin e familjes dhe ofrohen këto shërbime për fëmijët dhe familjet:

- Sigurimi që familjet të kenë qasje në shërbimet thelbësore për fëmijën, për të përmbushur nevojat e tyre zhvillimore. Kjo përfshin këshillim për fëmijë, psikoterapi, aktivitete rekreative dhe socio-kulturore, klube për fëmijë, trajnime, mbështetje materiale, edukative, seanca pedagogjike individuale, mbështetje shëndetësore dhe psiko-sociale. Këto shërbime arrijnë drejtpërdrejt tek fëmijët.



Kërkesë për propozim dhe TeR për Vlerësimin e Jashtëm

- Mbështetja e familjeve për të zhvilluar aftësitë e tyre për të mbrojtur dhe për t'u kujdesur për fëmijët e tyre. Kjo përfshin mbështetjen e kujdestarëve për të zhvilluar njohuritë dhe aftësitë e tyre prindërore; për të siguruar një burim të qëndrueshëm burimesh (p.sh. të ardhura dhe prodhimi i ushqimit) për të siguruar nevojat e zhvillimit të fëmijëve të tyre tani dhe në të ardhmen; dhe për të menaxhuar burimet e tyre në mënyrë efikase. Këto shërbime përfshijnë ngritjen e kapaciteteve prindërore, mbështetjen psikologjike, psikoterapi, grupin e mbështetjes së prindërve, aktivitete argëtuese dhe socio-kulturore, trajnime etj.
- Kujdestarët fuqizues ekonomikisht punojnë me familjet për t'i ndihmuar ata të rrisin të ardhurat e tyre (gjenerimin e burimeve) në mënyrë që fëmijët të përfitojnë realisht nga më shumë burime familjare. Mbështetja e pjesëmarrësve është e shumëfishtë dhe përfshin aktivitete për të përmirësuar ose për t'iu qasur: punësimit (p.sh. organizimi ose lidhja me trajnimin teknik dhe të aftësive, praktika dhe vendosja në punë); vetëpunësimi/sipërmarrja (p.sh. organizimi ose lidhja me trajnimin teknik dhe të aftësive, lehtësimi i qasjes në kredi, lehtësimi i kooperativave); prodhimi për konsum (p.sh. sigurimi i mbështetjes fillestare).
- Fuqizimi i sistemeve mbështetëse për fëmijët në nevojë dhe familjet e tyre brenda komunitetit. Në veçanti, mbështetja u jepet anëtarëve të komunitetit (nga grupi i synuar, ofruesit e shërbimeve përkatëse ose anëtarë të tjerë të interesuar të komunitetit) për t'u vetëorganizuar, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të zhvillojnë dhe mbështesin reagimin e tyre ndaj nevojave të grupeve të cënueshme të fëmijëve dhe familjeve të tyre. Këto shërbime arrijnë tek fëmijët përmes komuniteteve të tyre.

Programi i Fuqizimit të Familjes punon për të siguruar që të katër nivelet e shërbimeve (siç përshkruhen më lart) të adresohen në mënyrë efektive.

Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, përbërja etnike e vendit është e larmishme; komuniteti shqiptar i Kosovës, i cili përbën mbi 90 për qind të popullsisë (përllogaritur më pak se 2 milionë në vitin 2015) dhe serbët e Kosovës që përbëjnë rreth 5 për qind të popullsisë janë grupet kryesore etnike. Popullsia është relativisht e re, ku gjysma e popullsisë së saj (rreth 900,000) është nën moshën 18 vjeçare, numri i vlerësuar i fëmijëve nga 0 deri në 5 vjeç është 250,000. Nga 1,739,825 banorë, 92% janë shqiptarë të Kosovës, 5,3% serbë dhe grupe të tjera etnike 2,7%.

Për politikën e punësimit, Kosova ka vazhduar me hartimin e një strategjie të re të punësimit dhe tregut të punës 2023-2028, një politikë të re të punësimit 2022-2024 dhe një koncept dokument që rregullon fushën e punësimit. Sipas raportit të progresit të Kosovës, shkalla e papunësisë në vitin 2022 ishte 12.6% (20.7% në 2021). Normat janë më të larta te femrat, 16.5% (25% në 2021), sesa te meshkujt, 11% (19% në 2021). Treguesit që ende shkaktojnë më shumë shqetësime janë shkalla e lartë e pasivitetit, 61.4% (60.8% në 2021) dhe papunësia e të rinjve 21.4% (38% në 2021). Papunësia është edhe më e lartë (mbi 90%) në komunitetin rom dhe ashkali. Për përfshirjen dhe mbrojtjen sociale, shpenzimet e Kosovës në skemën e asistencës sociale arrijnë në 6% të PBB-së/GDP. Rreth 18% e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë (45 euro në muaj, 5.1% e popullsisë që jeton nën kufirin e varfërisë ekstreme). Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2019, në Kosovë, 22.7% e fëmijëve jetojnë në varfëri dhe 7% e fëmijëve jetojnë në varfëri ekstreme. Rreth 9% e fëmijëve janë të përfshirë në punë, nga të cilët 5.6% punojnë në kushte të rrezikshme, një çështje që është veçanërisht e dukshme në mesin e komuniteteve rom dhe ashkali.

1.3 Arsyetimi dhe objektivi i përgjithshëm i vlerësimit të jashtëm

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë planifikojnë të kryejnë vlerësime periodike (3-5 vjet) të pavarura të jashtme të programeve të zbatuara. Në këtë rast, vlerësimi i jashtëm është paraparë të bëhet për Programin e Fuqizimit të Familjës, lokacionin Fushë Kosovë.

Kërkesë për propozim dhe TeR për Vlerësimin e Jashtëm

Kërkohe një kompani e jashtme vlerësimi (ekipi i vlerësimit) për të ndërmarrë vlerësimin për të siguruar një vlerësim të pavarur dhe objektiv të rezultateve të programit.

Qëllimi kryesor i vlerësimit të jashtëm është të vlerësohet rëndësia, koherenca, efektiviteti, efikasiteti, ndikimi dhe qëndrueshmëria e programit. Vlerësimi i jashtëm duhet gjithashtu të analizojë progresin e arritur nga programi në fuqizimin e familjeve për të forcuar kapacitetet e tyre për të mbrojtur dhe për t'u kujdesur për fëmijët e tyre, si dhe për të forcuar rrjetet e sigurisë për fëmijët në nevojë dhe familjet e tyre brenda komunitetit në rajonin e Fushë Kosovës.

Udhëzim për ofertuesit

Ofertuesit janë të mirëpritur të dorëzojnë propozimin e tyre për vlerësim të jashtëm të Programit të Fuqizimit të Familjës në lokacionin e Fushë Kosovës. Kjo ofertë është e hapur për të gjithë kompanitë kombëtare, të cilët janë të themeluar ligjërisht dhe mund të ofrojnë shërbimet e kërkuara. Propozimi dhe të gjitha dokumentet plotësuese duhet të dorëzohen në shqip ose anglisht. Oferta financiare duhet të deklarohet në euro pa tvsh.

1.4 Procesi i dorëzimit të ofertave

Ofertuesit janë të mirëpritur të dërgojnë propozimin e tyre për vlerësimin e jashtëm të FSP Fushë Kosovë, në mënyrë elektronike në formatin PDF në email adresën: procurement1@soskosova.org

Gjatë procesit të vlerësimit, fillimisht do të hapen dhe vlerësohen ofertat teknike. Pjesa financiare e atyre propozimeve, të cilat janë përzgjedhur do të hapet pas vlerësimit të propozimit teknik.

Dokumentet që duhet të dorëzohen

- Certifikata e regjistrimit të biznesit/ NUI;
- Propozimi financiar duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur me logon zyrtare;
- Propozimi financiar duhet të deklarohet në EURO pa TVSH;
- Dorëzimi i ofertës: Propozimi teknik me metodologji vlerësimi me kornizën e mjeteve/instrumenteve të punës për mbledhjen e të dhënave që do të përdoren;
- Emri dhe detajet e kontaktit të kompanisë si dhe përshkrimi i përvojave përkatëse të mëparshme në vlerësime të tilla ose të ngjashme (Lista e Vlerësimeve të mëparshme të Jashtëm/vlerësime të ngjashme të publikuara);
- CV-të e anëtarëve të ekipit kërkimor të kompanisë;
- Tri letra reference (të paktën dy prej tyre duhet të njohin punën tuaj);
- Një shembull i një raporti vlerësimi të kohëve të fundit/përkatës (nëse është i disponueshëm për përdorim publik);
- Portofoli i kompanisë;
- Vlerësim i shkurtër kontekstual.

Përpara nënshkrimit të kontratës:

- Ofertuesi i përzgjedhur para nënshkrimit të kontratës duhet të paraqes Vërtetimin Tatimor.

Oferta financiare duhet të jetë e vlefshme për 60 ditë

1.5 Afati i fundit për dorëzimin

Propozimi duhet të pranohet më së voni më 14 Maj 2024.

1.6 Modifikimi dhe tërheqja e ofertave

Propozimet mund të tërhiqen me kërkesë me shkrim përpara datës së mbylljes së kësaj ftese. Çdo korrigjim ose ndryshim duhet të pranohet përpara datës së mbylljes. Ndryshimet duhet të shprehen

Kërkesë për propozim dhe TeR për Vlerësimin e Jashtëm

qartë në krahasim me propozimin origjinal. Nëse nuk bëhet kjo nënkupton rrezik dhe disavantazh për vetë ofertuesit.

1.7 Nënshkrimi i kontratës

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë do ta informojë ofertuesin e suksesshëm në mënyrë elektronike dhe do ta dërgojë formularin e kontratës brenda 3 javësh pas mbylljes së afatit për dorëzimin e ofertave. Ofertuesi i suksesshëm do të nënshkruajë kontratën dhe do të vendos datën dhe do ta kthejë në SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë brenda shtatë ditëve kalendarike nga dita e pranimit të kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës nga dy palë, ofertuesi i suksesshëm do të ofrojë shërbimet në përputhje me kohëzgjatjen për ofrimin e shërbimeve të përshkruar në ofertë.

1.8 Të drejtat e SOS Fshatrave të Fëmijëve Kosovë

- kontakton ndonjërin ose të gjitha referencat e dorëzuara nga ofertuesi(t);
- kërkon të dhëna shtesë mbështetëse ose plotësuese (nga ofertuesi(ët));
- refuzon ndonjë ose të gjitha propozimet e dorëzuara;
- pranon çdo propozim tërësisht ose pjesërisht;
- negocion me ofruesin(ët) e shërbimit që ka/kanë arritur vlerësimin/renditjen më të mirë, d.m.th. me ata që ofrojnë propozimin(et) me vlerën më të mirë të përgjithshme;

1.9 Vlerësimi i propozimeve

Pas hapjes, çdo propozim do të vlerësohet fillimisht për cilësinë e tij teknike me metodologjinë e vlerësimit dhe përputhshmërinë dhe më pas për çmimin e tij. Propozimi me vlerën më të mirë të përgjithshme, i përbërë nga merita teknike dhe çmimi, do të konsiderohet për miratim. Propozimi teknik vlerësohet në bazë të përgjegjshmërisë së tij ndaj Termave të Referencës (TeR). Ofertuesve gjithashtu mund t'u kërkohej të japin informacione shtesë për shërbimet e propozuara.

Kriteret e përzgjedhjes janë:

Kriteret	Pikat maksimale
<ul style="list-style-type: none"> • Kompania duhet të demonstrojë një kuptueshmëri të thellë të kontekstit lokal, duke përfshirë faktorët socio-ekonomikë, normat kulturore dhe kornizën ligjore relevante për mbrojtjen e fëmijëve dhe shërbimet mbështetëse të familjes në zonën e synuar (p.sh., Komuna e Fushë Kosovës). Kompania duhet të ofrojë një vlerësim të kuptueshmërisë së kontekstit të situatës së fëmijëve dhe familjeve në rrezik në Fushë Kosovë. • Portfolio e kompanisë: Kompania duhet të ketë njohuri dhe përvojë në fushën e shërbimeve sociale. Kualifikimet akademike të stafit në shkencat sociale si Punë Sociale, Psikologji, Sociologji, Pedagogji Sociale, Zhvillim të komunitetit ose në çdo fushë të ngjashme janë avantazh. Njohja e gjuhës shqipe dhe njohja e gjuhës angleze është përparësi. Të paktën 3 vjet përvojë/ ekspertizë e dëshmuar në vlerësimin e projekteve, vlerësimin e nevojave, kërkimin shkencor, publikimet ose çdo ekspertizë të ngjashme. • Përvoja e stafit të kompanisë në procese të tilla kërkimore (bashkëngjitni CV-të e stafit që do të punojë). Ato do të vlerësohen në bazë të kualifikimit dhe përvojës). 	35
<ul style="list-style-type: none"> • Metoda (metodologjia) e propozuar për kryerjen e vlerësimit të jashtëm është e përshtatshme dhe orari/plani i punës është realist dhe përmbush qëllimin. 	35
<ul style="list-style-type: none"> • Kostoja e propozimit financiar 	30
Gjithsej	100

Të gjithë ofertuesit duhet të plotësojnë kriteret thelbësore.

Kërkesë për propozim dhe TeR për Vlerësimin e Jashtëm

2 Termat e referencës

2.1 Objektivat e vlerësimit

2.1.1 Objektivi i përgjithshëm

Objektivi i përgjithshëm i këtij vlerësimi të jashtëm është të vlerësojë progresin e arritur nga Programi për Fuqizimit të Familjes për fëmijët dhe familjet në Fushë Kosovë. Qëllimi kryesor i vlerësimit të jashtëm është të vlerësojë rëndësinë, koherencën, efektivitetin, efikasitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e programit. Gjetjet dhe rekomandimet e vlerësimit do të përdoren si bazë për planifikimin strategjik në nivel kombëtar; për përmirësimin e hartimit të programit dhe për zhvillimin e ardhshëm të qasjes së fuqizimit të familjes dhe në nivel kombëtar.

2.1.2 Objektivat specifike

- Vlerëson rëndësinë e ndërhyrjeve kundrejt rezultateve të planifikuara të programit
- Vlerëson efektivitetin e ndërhyrjes në bërjen e ndryshimeve të dëshiruara në jetën e fëmijëve dhe familjeve pjesëmarrëse,
- Vlerëson efikasitetin e programit në lidhje me pjesëmarrësit, koston dhe kornizën kohore.
- Analizon qëndrueshmërinë e programit (institucional, social, financiar, etj.)
- Bën rekomandime për përmirësimin e zhvillimit të ardhshëm të ndërhyrjeve programore.
- Dokumenton/vlerëson shifrat aktuale të treguesve objektivisht të verifikueshëm siç gjenden në dokumentet e programit (Shënimi i konceptit dhe Korniza e Rezultateve)

2.1.3 Fushëveprimi

Vlerësimi synon të vlerësojë ndryshimet në jetën e fëmijëve dhe të familjeve të tyre dhe të komuniteteve të tyre dhe progresin e përgjithshëm të Programit të Fuqizimit të Familjes në lokacionin e Fushë Kosovës.

Vlerësimi duhet të identifikojë mësimet kryesore të nxjerra që mund të zbatohen për të përmirësuar rëndësinë; koherencën, efikasitetin; efektivitetin; qëndrueshmërinë dhe ndikimin e ndërhyrjeve të programit.

Qasja e vlerësimit

Vlerësimi i jashtëm duhet të përdorë metodologji pjesëmarrëse për të përfshirë pjesëmarrësit e programit (familjet që janë aktualisht në program si dhe familjet që janë larguar tashmë nga programi) dhe kudo që është e mundur fëmijët, të rinjtë duhet të përfshihen në hartimin dhe zbatimin e vlerësimit. Ekipi i vlerësimit duhet të respektojë të drejtat e pjesëmarrësve të pjesëmarrësve të programit në lidhje me pjesëmarrjen vullnetare në vlerësim, duke përfshirë të drejtën e tyre për t'u tërhequr nga pjesëmarrja në çdo fazë nëse ata vendosin kështu. Si një kërkesë minimale, ky ushtrim vlerësimi shqyrton ndryshimet që kanë ndodhur në jetën e familjes pjesëmarrëse për shkak të pjesëmarrjes së tyre në program.

Qasja e vlerësimit duhet të jetë gjithashtu e orientuar drejt rezultateve për të ofruar dëshmi të arritjeve sasiore dhe cilësore dhe të produkteve dhe rezultateve të marra nga programet (ose jo). Të dhënat parësore dhe dytësore duhet të përdoren në vlerësim dhe të mblidhen nga një gamë e gjerë dhe e larmishme burimesh parësore dhe dytësore. Informacionet dytësore duhet të mblidhen nga dokumentet që i janë dhënë vlerësuesit. Informacionet parësore duhet të mblidhen nga akterët e programeve nëpërmjet vëzhgimeve të drejtpërdrejta në terren, intervistave gjysmë të strukturuar dhe diskutimeve

Kërkesë për propozim dhe TeR për Vlerësimin e Jashtëm

në grupe të fokusuara me anëtarët e stafit të programit, si dhe pjesëmarrësit e programit, si dhe akterët kryesor.

Plani i punës së bashku me metodologjinë e propozuar të vlerësimit të ofruar nga kompania duhet të përshkruajë në detaje metodologjinë (metodat dhe mjetet e punës) duke përfshirë objektivat kryesore, pyetjet kryesore, hapat dhe procedurat se si të kryhet vlerësimi, metodën e përzgjedhjes së mostrës, metodat e mbledhjes së të dhënave, afatin kohor, etj.

Pyetjet e vlerësimit duhet të sillen rreth kriterëve të mëposhtme sipas DAC: **rëndësia, koherenca, efektiviteti, efikasiteti, ndikimi dhe qëndrueshmëria**. Instrumentet/pyetësorët për detyrat në terren duhet të përgatiten për akterët duke u bazuar në kriteret e mësipërme të vlerësimit.

Procesi i mbledhjes së të dhënave përfshin:

- Rishikimin e dokumentacionit të programit dhe burime të tjera informacionesh në nivel programi
- Identifikimin e akterëve kryesor që janë të lidhur me programin që do të intervistohet, si p.sh. pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë të programit (fëmijët, kujdestarët) partnerët e zbatimit, përfaqësuesit kryesorë të pushtetit vendor dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve
- Përzgjedhja e mostrës përfaqësuese të komuniteteve ose grupeve që do të intervistohen bazuar në kriteret e dakorduara
- Dakordimi për llojin e informacioneve që do të mblidhen
- Zhvillimi i mjeteve metodologjike për mbledhjen e të dhënave dhe konsultohimi me stafin e programit në nivel programi /kombëtar/kontinental
- Plotësimi i pyetësorëve dhe kryerja e intervistave me pjesëmarrësit në program, bashkëpunëtorët, përfaqësuesit e partnerëve, autoritetet lokale dhe komuniteti, fokus grupet dhe analiza e të dhënave.
- Vlerësimi duhet të përdorë metoda sasiore (p.sh. anketat) dhe metoda cilësore të mbledhjes së të dhënave, siç janë intervistat gjysmë të strukturuar (për shembull me grupet e fokusit, informatorët kyç, grupet e mëdha, intervistat individuale, etj.) analiza e të dhënave, SËOT Analiza.
- Metodat e mbledhjes së të dhënave si intervistat, fokus grupet ose anketat duhet të përmbajnë pyetje që janë objektive, të kuptueshme për pjesëmarrësin, të paanshme dhe nuk duhet të jenë të njëanshme apo çorientuese.
- Gjatë gjithë procesit të kryerjes së Vlerësimit, është i detyrueshëm respektimi i pavarësisë së individëve që marrin pjesë në fazën e mbledhjes së të dhënave të vlerësimit duke marrë një dokument të kuptueshëm të pëlqimit të informuar.

Analiza e të dhënave dhe përpunimi i raportit të vlerësimit.

Vlerësuesi i jashtëm do të analizojë të dhënat e mbledhura dhe do të përgatisë një raport vlerësimi që përshkruan gjetjet, rekomandimet dhe mësimet e nxjerra nga vlerësuesi kryesor. Raporti përfundimtar duhet të ndjekë strukturën dhe përmbajtjen siç përshkruhet në termat e referencës. Kjo fazë përfshin:

- Analizën e të dhënave dhe përpunimin e konkluzioneve dhe rekomandimeve
- Përgatitjen e një draft raporti
- Prezantimin e gjetjeve tek stafi i programit përkatës në nivel lokal/kombëtar dhe rajonal/kontinental për të siguruar triangulimin
- Finalizimi i raportit pas të dhënave nga akterë të ndryshëm

Pjesëmarrësit kryesorë të vlerësimit janë:

- Pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë në program (familjet /prindërit/të rinjtë dhe fëmijët e marginalizuar, familjet që u larguan nga programi)

Kërkesë për propozim dhe TeR për Vlerësimin e Jashtëm

- Akterët e drejtpërdrejtë (organet shtetërore dhe komunale në mbrojtjen, arsimin, mirëqenien e fëmijëve, autoritete të tjera lokale, komunitet, etj.)
- Stafi i programit (punonjësit social, psikologët, pedagogët, menaxherët e programit dhe specialistë të tjerë të punësuar)
- Niveli kombëtar (Drejtori i Programit të Fshatit të Fëmijëve – lokacioni në Prishtinë, Zyra për Zhvillimin e Programit – Këshilltari i Programit Kombëtar)

Ekipi vlerësues i kompanisë duhet të respektojë kulturën, normat sociale, vlerat dhe sjelljen e komuniteteve pjesëmarrëse; dhe të mbajë marrëdhënie të përshtatshme me pjesëmarrësit gjatë vlerësimit. Ekipi i vlerësimit duhet të respektojë konfidencialitetin e informacioneve të mbledhura nga të anketuarit. Ata duhet të respektojnë standardet relevante për hulumtimet në fushën e mbrojtjes së fëmijëve dhe të respektojnë standardet e sjelljes që janë të pranueshme për SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë. Ekipi i ekspertëve të kompanisë duhet të nënshkruajë Kodin e Sjelljes, Politikat e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe të gjitha deklaratat përkatëse që garantojnë mbrojtjen e të dhënave dhe konfidencialitetin përpara fillimit të vlerësimit.

Dokumentet kryesore të referencës:

Dokumentacioni i programit:

- Koncept Dokumenti
- Korniza e Rezultateve;
- Përshkrimi i shërbimit kombëtar për fuqizimin e familjes;
- Korniza logjike FBC and FSP P
- PP FBC- FSP (Increased Quality of Services and additional Economic Empowerment services in existing FSPs, 2014)
- Vlerësimi i jashtëm I Programit të Fuqizimit të Familjes Fushë Kosova 2013-2017
- Rezultatet vjetore të vetëvlerësimit (2020 dhe 2021);
- Raportet vjetore (2020, 2021, 2022 dhe 2023);
- Koncepti kombëtar i fuqizimit ekonomik;
- Raportet e bazës së të dhënave të programit SOS.

Dokumentet e brendshme SOS:

- Strategjia afatmesme e Kosovës
- Planet vjetore të Kosovës
- Plani i programit CV
- Prioritetet e premtimit për kujdes nga SOS
- SOS Politika për mbrojtjen e fëmijëve
- Udhëzuesi për procedurat e menaxhimit të rasteve në kuadër të projekteve për fuqizimin e familjes 2012

Dokumentet e jashtme:

- Plani strategjik kombëtar 2019-2023 mbrojtja e fëmijëve
- Kërkesat ligjore kombëtare dhe udhëzuesi për rregullimin e shërbimeve
- Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijës
- Objektivat e OKB-së për zhvillim të qëndrueshëm
- Udhëzuesi i OKB-së për kujdesin alternativ të fëmijëve,

Fushat kyçe për vlerësim të jashtëm:

Në kuadër të programit të fuqizimit të familjes, janë mbështetur fëmijët, familjet dhe komunitetet në fusha të ndryshme, të cilat duhet t'i shikojë ushtrimi i vlerësimit të jashtëm. Vlerësimi do të fokusohet në fushat kyçe dhe grupin ilustrues të pyetjeve udhëzuese të paraqitura në vijim. Prandaj, ekipi i

Kërkesë për propozim dhe TeR për Vlerësimin e Jashtëm

vlerësimin duhet të vendosë në bashkëpunim me ekipin kombëtar të programit se cilat nga fushat e përmendura më poshtë dhe në çfarë mase zbatohen për programin e caktuar dhe grupi i pyetjeve do të shtjellohet më tej gjatë fazës përgatitore.

Çështja e vlerësimit	Pyetjet kryesore udhëzuese	Burimet e informacionit
Rëndësia A e trajton programi situatën e grupit të synuar specifik?	<ul style="list-style-type: none"> • Deri në çfarë mase programi është fokusuar në grupin e synuar - p.sh. prindër/kujdestarë të marginalizuar, fëmijë dhe të rinj, specialistë shtetërorë? • Deri në çfarë mase prindërit (familjet) dhe fëmijët e pranuar në program i kanë përmbushur kriteret e përzgjedhjes. • Deri në çfarë mase, ndërhyrjet e programit u përgjigjen nevojave dhe prioriteteve të pjesëmarrësve të programit. • Deri në çfarë mase hartimi i programit adreson nevojat dhe prioritetet e përcaktuara në nivel lokal (të komunitetit lokal)? • Deri në çfarë mase u morën parasysh nevojat dhe prioritetet e pjesëmarrësve gjatë hartimit të programit? • Deri në çfarë mase objektivat dhe aktivitetet e programit janë në përputhje me nevojat e grupit të synuar? 	<p>Dokumentet</p> <ul style="list-style-type: none"> 📖 Koncept Notë 📖 Kornizë logjike 📖 Korniza e rezultateve 📖 Përshkrimi i Shërbimit për programin e fuqizimit të familjes 📖 Manuali i PFF 📖 Raportet vjetore SOS dhe PFF 📖 Raporti i vetëvlerësimit 📖 Menaxhimi i rastit/Planet e zhvillimit të familjes 📖 Planet e Aktiviteteve <p>Njerëzit</p> <ul style="list-style-type: none"> ↑ Pjesëmarrësit e programit, ish-pjesëmarrësit e programit ↑ Stafi i PFF të programit
Koherenca: Sa mirë përshtatet ndërhyrja.	<ul style="list-style-type: none"> • Deri në çfarë mase ndërhyrja e programit është në përputhje me ndërhyrjet e tjera në një vend në të njëjtën zonë? • Deri në çfarë mase programi nuk mbivendoset me shërbimet e tjera në vendndodhje? Çfarë është ende relevante apo jo relevante? • Deri në çfarë mase ndërhyrja e programit është në koordinim me akterët e tjerë vendorë? 	<p>Dokumentet</p> <ul style="list-style-type: none"> 📖 Koncept Notë 📖 Korniza logjike 📖 Korniza e rezultateve 📖 Përshkrimi i shërbimit 📖 Manuali i PFF 📖 Premtimi për Kujdesin e SOS 📖 Korniza ligjore 📖 Standardet minimale të cilësisë për shërbimet sociale 📖 Planet e Aktiviteteve 📖 Marrëveshjet e partneritetit <p>Njerëzit</p> <ul style="list-style-type: none"> ↑ QPS



Kërkesë për propozim dhe TeR për Vlerësimin e Jashtëm

		<ul style="list-style-type: none"> ↑ Partnerët (organet publike, organe të tjera qeveritare, OSHC, partnerë të tjerë kyç në zbatim) ↑ Stafi i programit, Vendndodhja e PFF
<p>Efektiviteti: Deri në çfarë mase janë arritur ose pritet të arrihen objektivat e ndërhyrjes zhvillimore, duke marrë parasysh rëndësinë e tyre relative.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Deri në çfarë mase po arrihen objektivat e programit? • Sa përqind janë arritur aktivitetet e programit kundrejt treguesve të përcaktuar? • Deri në çfarë mase strategjitë, metodologjitë, mjetet dhe proceset e programit kontribuuan në arritjen e rezultateve të planifikuara. <p>(në lidhje me krijimin e vetëmbështetjes në familje)</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sa fëmijë dhe familje kanë marrë pjesë në program? A kanë nevojë të gjithë për shërbimet e programit? • Deri në çfarë mase fëmijët kanë mbetur në familjet e tyre në vend që ta humbin kujdesin e tyre? Deri në çfarë mase është përmirësuar cilësia e jetës së tyre? Dimensionet për vlerësim janë shëndeti, mirëqenia sociale dhe emocionale, arsimit, jetesa, akomodimi, mbrojtja dhe kujdesi. • Sa fëmijë dhe familje e lanë me sukses programin që nga fillimi dhe u mbështetën te vetja? Deri në çfarë mase rezultatet që ata arritën janë të qëndrueshme dhe efektive pasi ata u larguan nga programi? • Deri në çfarë mase pjesëmarrësit janë të kënaqur me ndërhyrjet e programit? • Deri në çfarë mase grupet e synuara janë të vetëdijshme për programin dhe shërbimet që ai ofron. A marrin shërbime nga programi të gjitha familjet e grupit të synuar? • Cilat janë arsyet që familjet e tjera të dështojnë në arritjen e mbështetjes te vetja deri në fund të periudhës së vlerësuar? • Cilat qasje dhe strategji të përcaktuara në planet e zhvillimit të familjes kanë qenë më efektive dhe kontribuuese në arritjen e mbështetjes te vetja? <p>(në lidhje me reagimeve të qëndrueshme të bazuara në komunitet)</p> <ul style="list-style-type: none"> • A i përgjigjet në mënyrë efektive sistemi mbështetës që po ndërtohet në komunitetet e synuara situatës së fëmijëve në rrezik për ta humbur kujdesin prindëror? • Në çfarë mase ka kontribuar SOS në zhvillimin e kapaciteteve të partnerëve publikë/privatë dhe bartësve kryesorë të detyrës për t'iu përgjigjur situatës së grupit të synuar? • Deri në çfarë mase komuniteti tregon interes për rezultatet e programit? 	<p>Dokumentet</p> <ul style="list-style-type: none"> 📄 Raportet tremujore mbi progresin 📄 Koncept Nota Shërbimi 📄 Korniza e rezultateve 📄 Përshkrimi për programin e fuqizimit të familjes 📄 Plani vjetor i programit të SOS me rishikim 📄 Raportet vjetore të SOS 📄 Raporti i vetëvlerësimit 📄 Statistikat e Planifikimit të Zhvillimit Familjar 📄 Marrëveshjet e partneritetit <p>Njerëzit</p> <ul style="list-style-type: none"> ↑ Fëmijë, familje dhe specialistë shtetërorë që marrin pjesë ose kanë marrë pjesë në program ↑ Partnerët (partneri kryesor i zbatimit, organet publike dhe partnerët privatë) ↑ Stafi i programit të me lokacion në Fushë Kosovë <p>Baza e të dhënave të SOS për FF</p>



Kërkesë për propozim dhe TeR për Vlerësimin e Jashtëm

	<ul style="list-style-type: none">• Deri në çfarë mase autoritetet vendore janë të përfshira dhe ofrojnë mbështetje për programin?• A kërkohet përsëritja ose heqja e disa qasjeve për ta rritur efektivitetin?	
Efikasiteti: Si shndërrohen burimet/inputet (fondet, ekspertiza, koha, etj.) në rezultate	<ul style="list-style-type: none">• A është lidhja ndërmjet inputit të burimeve dhe rezultateve të arritura e përshtatshme dhe e justifikueshme (raporti kosto-përfitim)? Cilat janë përfitimet sociale për fëmijët/familjet/komunitetet krahasuar me burimet e shpenzuara për aktivitete?• Cilat janë kostot totale vjetore të funksionimit dhe kostot mesatare të funksionimit për fëmijë në muaj? Dhe si krahasohen këto kosto me nismat e ngjashme në vend?• A janë përdorur burimet në mënyrë më ekonomike?• A ka ndonjë alternativë për ta arritur të njëjtin rezultat me më pak të dhëna? A ka opsione të mundshme për zvogëlimin e koston dhe kursimin e koston duke realizuar të njëjtin nivel rezultatesh dhe cilësie?• A mund të ishin arritur rezultatet me kosto më të ulët duke zbatuar një qasje tjetër?	<p>Dokumentet</p> <ul style="list-style-type: none">📖 Plani vjetor i programit të SOS me rishikim📖 Raportet vjetore të SOS📖 Raporti i vetëvlerësimit📖 Statistikat e Planifikimit të Zhvillimit Familjar📖 Marrëveshjet e partneritetit <p>Njerëzit</p> <ul style="list-style-type: none">† Fëmijët, më të vegjlit dhe familjet që marrin pjesë ose kanë marrë pjesë në program† Partnerët (organet publike, qeveria, partneri kryesor implementues)† Palët e tjera të interesit† Stafi i programit me lokacion në Fushë Kosovë



Kërkesë për propozim dhe TeR për Vlerësimin e Jashtëm

<p>Ndikimi Analiza sistematike e ndryshimeve në jetën e fëmijëve, familjeve, komuniteteve dhe akterëve të tjerë të sjellë nga Programi</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Cili ka qenë ndikimi në përputhje me rezultatet e planifikuara të programit sa i përket ndryshimeve të sjella në situatën e fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve? • Cili ka qenë ndikimi përtej rezultateve të planifikuara të programit sa i përket ndryshimeve të sjella në situatën e fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve? (pozitive dhe/ose negative) 	<p>Dokumentet</p> <ul style="list-style-type: none"> 📖 Plani i lokacionit 📖 Plani CVPP 📖 Raporti i vetëvlerësimit 📖 Rastet familjare <p>Njerëzit</p> <ul style="list-style-type: none"> ↑ Fëmijët dhe familjet që marrin pjesë ose kanë marrë pjesë në program ↑ Partnerët (organet publike, qeveria, partneri kryesor implementues) ↑ Palët e tjera të interesit ↑ Stafi i Programit në Fushë Kosovë <p>Të dhënat e bazës së të dhënave të SOS për FF</p>
<p>Qëndrueshmëria</p>	<ul style="list-style-type: none"> • A mbështetet programi nga institucionet lokale/kombëtare? A demonstrojnë këto institucione përkushtim dhe kapacitet për t'i vazhduar aktivitetet e programit apo për ta përsëritur atë? • Deri në çfarë mase mund të pritet të vazhdojnë aktivitetet, rezultatet dhe efektet pasi të ketë përfunduar përfshirja e SOS? A kanë partnerët kapacitete financiare për ta vazhduar programin? 	<p>Njerëzit</p> <ul style="list-style-type: none"> ↑ Fëmijët, të rinjtë dhe prindërit (familjet) dhe partnerët shtetërorë që marrin pjesë ose kanë marrë pjesë në program ↑ Partnerët (organet publike, qeveria, partneri kryesor i zbatimit) ↑ Stafi i Programit në Fushë Kosovë

Kërkesë për propozim dhe TeR për Vlerësimin e Jashtëm

<p>Menaxhimi dhe koordinimi i programit A siguron menaxhimi dhe koordinimi i programit zbatimin cilësor të programit</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Deri në çfarë mase programi ka strukturat e duhura të menaxhimit dhe koordinimit dhe organizimin e procesit? A synojnë këto struktura cilësinë e zbatimit të programit? • Kush tjetër nga partnerët lokalë është i përfshirë në procesin e menaxhimit dhe koordinimit dhe si ndikon ai në zbatimin cilësor? 	<p>Dokumentet</p> <ul style="list-style-type: none"> 📖 Raportet e progresit 📖 Marrëveshjet e partneritetit <p>Njerëzit</p> <ul style="list-style-type: none"> † Menaxhimi i programit † Partnerët (organet publike, qeveria, partneri kryesor implementues) † Stafi i Programit në Fushë Kosovë
--	--	--

2.1 Plani i punës dhe rezultatet e pritshme

Vlerësimi do të kryhet në 3 faza. Të gjithë hapat që çojnë në rezultate janë shënuar me shkronja të zeza.

Faza 1: Përgatitja

Ndërmerni të gjitha përgatitjet e nevojshme për vlerësimin në terren: propozoni metodologjinë e detajuar, rishikoni metodologjinë e propozuar në bashkëpunim të ngushtë me SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, kryeni hulumtime në zyrë (duke analizuar të gjitha dokumentet në lidhje me detyrën), identifikoni informatorët kryesorë, planifikoni procesin e mbledhjes së të dhënave, organizimin dhe logjistikën dhe përgatitni orarin e vizitave në terren.

Paraqisni dhe siguroni miratimin për dizajnin dhe metodologjinë e përmirësuar të vlerësimit në një **raport fillestar**: (i) konfigurimin metodologjik të propozuar, (ii) mjetet e mbledhjes së të dhënave të përshtatura dhe të propozuara në nivel lokal. Përgatitja e listave kontrolluese, listave të pjesëmarrësve dhe informacioneve të tjera menaxheriale/organizative për mbledhjen e të dhënave dhe orarin e vizitave në terren.

Faza 2: Sjellja

Kompania mban diskutime paraprake me ekipin kryesor të projektit nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë.

- Lehtësoni të mësuarit gjatë ushtrimit të mbledhjes së të dhënave.
- Puna në terren me pjesëmarrësit, palët e interesit dhe partnerët kyç.
- Mbledhja e të dhënave sipas metodologjisë dhe mjeteve të dakorduara.
- Analiza e të dhënave.

Faza 3: Paraqisni gjetjet

Kompania dorëzon draft raportin(-et) e parë në gjuhën shqipe ose angleze dhe në përputhje me formatin e raportit të dhënë më poshtë.

- Prezantimi i gjetjeve tek ekipi i projektit / stafi i zyrës kombëtare (ballë për ballë).
- Pasi të keni marrë komente kthyese – finalizoni raportin dhe dorëzojeni atë në gjuhën shqipe ose angleze.

Rezultatet:

- Përsosja e dizajnit dhe metodologjisë së studimit të vlerësimit në një raport fillestar me një plan aktiviteti

Kërkesë për propozim dhe TeR për Vlerësimin e Jashtëm

- Drafti i parë i raportit përfundimtar në gjuhën shqipe ose angleze.
- Prezantimi i rezultateve preliminare në SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë (ballë për ballë)
- Raporti përfundimtar në gjuhën shqipe ose angleze

2.2 Kriteret e raportit

Vlerësimi do të rezultojë në raport konciz vlerësimi të Qendrës Mbështetëse për Fëmijët dhe Familjet, në gjuhën shqipe dhe angleze me një gjatësi maksimale prej 50 faqesh, duke përfshirë një Përmbledhje Ekzekutive. I gjithë informacioni konfidencial duhet të mbahet në një shtojcë të veçantë për t'i mbrojtur pjesëmarrësit. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet në mënyrë elektronike dhe në kopje fizike.

Formati i raportit duhet të jetë si më poshtë:

- Faqja e ballinës
 - Titulli i raportit të vlerësimit
 - Vendi, programi, data e vlerësimit
 - Emri i konsulentit
- Përmbledhja ekzekutive (*maksimumi 2 faqe*; faqet ose paragrafët me referime të kryqëzuara *në pjesën e zhvillimit të raportit*)
 - Veprim i vlerësuar
 - Qëllimi dhe metodologjia (përfshirë kufizimet dhe sfidat)
 - Konkluzionet kryesore, rekomandimet dhe mësimet e nxjerra
- Pjesa e zhvillimit të raportit
 1. Struktura e zhvillimit të raportit përcaktohet nga rezultatet e dëshiruara (Shih 2.3)
 2. Metodologjia dhe qasja e vlerësimit
 - 3. Gjetjet lidhur me rëndësinë, koherencën, efektivitetin, efikasitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë.
 - 4. Përfundimi dhe rekomandimi - për çdo përfundim kyç, duhet të ketë një rekomandim përkatës që është realist, pragmatik dhe operacional
- Shtojcat
 - Termat e Referencës
 - Lista e personave të intervistuar dhe vendet e vizituara
 - Harta e zonave të mbuluara nga programi
 - Të tjera

2.3 Kualifikimi i hulumtuesit / ekipit hulumtues

Hulumtuesi / ekipi hulumtues duhet të ketë:

- a) kompetencë/përvojë të dëshmuar (dëshmi të përvojave të mëparshme) në vlerësime të ngjashme;
- b) përvojë e dëshmuar në proceset pjesëmarrëse dhe metodat e mbledhjes së të dhënave (përfshirë metodat e mbledhjes së të dhënave të përshtatshme për moshën)
- c) Diplomë universitare në Punë Sociale, Psikologji, Pedagogji Sociale, Juridik, të Drejtat e Njeriut, të Drejtat e Fëmijëve ose përvojë ekuivalente profesionale.
- d) përvojë dhe kompetencë e mirë në analizën dhe vlerësimin e projekteve në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtave të fëmijëve, mirëqenies sociale dhe mbrojtjes së fëmijëve.
- e) duhet të ketë përvojë në zhvillimin dhe zbatimin e metodologjive të kërkuara të hulumtimit.
- f) i kupton mirë të drejtat e fëmijëve dhe çështjeve që prekin fëmijët në nevojë dhe familjet e tyre
- g) aftësi të mira lehtësuese, organizative dhe ndërpersonale
- h) aftësi të forta analitike dhe konceptuale
- i) aftësi të shkëlqyera komunikimi me shkrim
- j) duhet të ketë aftësi të mira personale dhe ndërpersonale të punës ekipore.
- k) duhet të garantojë dhënien në kohë të rezultateve dhe detyrave të pritura.
- l) duhet të jenë të familjarizuar me standardet etike për çështjet që lidhen me fëmijët dhe duhet ta nënshkruajnë dhe t'i përmbahen Politikës së Mbrojtjes së Fëmijëve.
- m) Autori nuk duhet të përdorë materiale të mbrojtura me të drejtë autori.

Kërkesë për propozim dhe TeR për Vlerësimin e Jashtëm

2.4 Orari

Vlerësimi do të kryhet gjatë muajve maj – qershor. Raporti përfundimtar duhet të dorëzohet deri më **25 korrik 2024**.

Për të siguruar një realizim pa pengesa të këtij vlerësimi, kompania lokale pritet t'i ndjekë detyrat e renditura më poshtë:

Aktivitetet	Korniza kohore	Lokacioni
Përgatitni vlerësimin dhe dorëzoni metodat e sugjeruara të mbledhjes së të dhënave dhe intervistoni palët e interesit tek organi kontraktues (raporti fillestar)	5 ditë	
Kryeni hulumtim në zyre (të përgjithshme)	2 dite	
Kryeni mbledhjen e të dhënave (intervista, fokus grupe, etj.)	10 dite	
Analizoni të dhënat	5 ditë	
Përgatitni draft raportin dhe prezantoni rezultatet te palët e ndryshme të interesit, përfshirë pjesëmarrësit në program	3 dite	
Inkorporoni komentet kthyesë dhe përgatitni raportin dhe prezantimin përfundimtar	2 ditë	

2.5 Kohëzgjatja e kontratës dhe kushtet e pagesës

Pagesa do të bëhet vetëm me pranimin nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë të punës së kryer në përputhje me rezultatet e përshkruara më sipër. Propozimet financiare duhet të përfshijnë pagesat e propozuara në faza. Pagesa do të ndikohet nga transferta bankare në valutën e faturimit dhe bëhet 30 ditë pas marrjes së faturës dhe pranimin të punës.

Pagesa: Konsulenti do të paguhet nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë si më poshtë:

25% pas paraqitjes dhe miratimit të raportit fillestar

25% pas paraqitjes dhe miratimit të draft raportit kur prezantohen rezultatet para palëve të ndryshme të interesit, përfshirë pjesëmarrësit e programit

50% pase përfundimit dhe miratimit të raportit përfundimtar

Kohëzgjatja e kontratës: kontrata hyn në fuqi nga momenti i nënshkrimit deri në pranimin e punës nga ekipi ndërkombëtar i projektit.

2.6 Njoftim për vonesë

Nëse ofertuesi i suksesshëm përballlet me vonesë në zbatimin e kontratës, e cila mund të jetë e falshme në rrethana të pashmangshme; kontraktori e njofton me shkrim SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë për shkaqet e vonesave të tilla brenda një (1) jave nga fillimi i vonesës.

Pas marrjes së njoftimit nga kontraktori për vonesë, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë do t'i analizojë faktet dhe masën e vonesës dhe do ta zgjasin kohën e kryerjes kur sipas gjykimit të saj faktet e justifikojnë një zgjatje të tillë.

2.7 E drejta e autorit dhe të drejtat tjera pronësore

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë gëzon të gjithë pronësinë intelektuale dhe të drejtat e tjera pronësore, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, të drejtat e autorit dhe markat tregtare, në lidhje me produktet, proceset, shpikjet, idetë, njohuritë teknike, dokumentet dhe materialet e tjera që kontraktori i ka zhvilluar për SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë sipas kontratës dhe të cilat kanë një lidhje të drejtpërdrejtë me ose janë prodhuar ose përgatitur ose mbledhur si pasojë ose gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori pranon dhe pajtohet se këto produkte, dokumente dhe materiale të tjera përbëjnë punë të bëra me qira për SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë.

Të gjitha materialet: planet, raportet, vlerësimet, rekomandimet, dokumentet dhe të gjitha të dhënat e tjera të përpiluara ose të marra nga Kontraktori sipas kontratës do të jenë pronë e SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë dhe do të trajtohen si konfidenciale dhe do t'i dorëzohen vetëm zyrtarëve të autorizuar të SOS Fshatratë Fëmijëve Kosovë për përfundimin e punëve sipas kontratës.

Kërkesë për propozim dhe TeR për Vlerësimin e Jashtëm

E drejta e autorit për produktet do t'i përkasë SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë dhe kompania nuk do të autorizohet t'i përdorë apo riprodhojë ato askund tjetër. Konsulenti i jashtëm është i obliguar që të gjitha të dhënat e papërpunuara të grumbulluara gjatë vlerësimit t'i dorëzojë në SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë.

2.8 Përfundimi

Me nënshkrimin e kontratës, në rast të performancës jo të kënaqshme, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë do të negociojë me kompaninë e përzgjedhur që të mund të ndërrohet puna/materialet. Nëse puna e kryer nuk arrin t'i përmbushë pritshmëritë, kontrata do të ndërpritet me një njoftim paraprak me shkrim prej shtatë ditësh. Ndërkohë SOS do të nisë një proces të ri përzgjedhjeje.

SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë ka të drejtë ta ndërpresë kontratën pa asnjë detyrim financiar në rast se kontraktori nuk i përmbush detyrimet e tij pa ndonjë njoftim paraprak:

- orarin e rënë dakord
- tërheqja ose ndërrimi i personelit kyç pa marrë pëlqimin me shkrim nga SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë
- rezultatet nuk përputhen me kërkesat e TeR

Kërkesë për propozim dhe TeR për Vlerësimin e Jashtëm

3 Shtojca

3.1 Politika për mbrojtjen e fëmijëve dhe kodi i sjelljes i SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë

SOS Fshatrat e Fëmijëve në Kosovë ka një politikë për mbrojtjen e fëmijëve dhe kodin e sjelljes, të cilave pritet që të gjithë konsulentët t'i përmbahen dhe do t'u kërkohej ta nënshkruajnë një deklaratë përkushtimi ndaj politikës. Kjo do të ndodhë me nënshkrimin e kontratës, së bashku me një orientim të konsulentëve mbi proceset e brendshme të mbrojtjes së fëmijëve dhe rregulloret për mbrojtjen e të dhënave.

Para fillimit të mbledhjes së të dhënave, duhet të sigurohet një kontroll policor, në rast se planifikohet ndonjë kontakt i drejtpërdrejtë me pjesëmarrësit e programit dhe/ose ndonjë të dhënë të ndjeshme.

Përveç sa u tha më sipër, duhet të merren parasysh fushat kryesore të mëposhtme për konsideratë etike: <http://childethics.com/ethical%20guidance/>

Graham, A., Poëell, M., Taylor, N., Anderson, D. & Fitzgerald, R. (2013). Ethical Research Involving Children. Florence: UNICEF Office of Research - Innocenti.

Ofertuesit të suksesshëm i kërkohej të marrë pëlqimin me shkrim nga të gjithë pjesëmarrësit në procesin e vlerësimit dhe/ose nga kujdestarët/përfaqësuesit e tyre zyrtarë (kur është e aplikueshme).